



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:240958

Datë: 03.12.2024

Numri i dokumentit: 06540428

**C.nr.247/21**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtarja Sabaheta Kurteshi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: **M. A., A. A. dhe I. A., që të gjithë nga fshati..., Komuna e Dragashit, me vendbanim në Prizren, Rr. “R. B.” nr..., të përfaqësuar nga av. S. B. nga Dragashi, kundër të paditurve Komuna Dragash me seli në Dragash, të cilën e përfaqëson sipas prokurës Islam Rexheplar nga Dragashi dhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës – Drejtoria Koordinuese Rajonale në Prizren e përfaqësuar nga A. S. nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimi i pronësisë**, me dt. 22.11.2024 mori ndërsa me datë 03.12.2024 përpiloi edhe këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **KONSTATOHET** se padia e paditësve: M. A., A. A. dhe I. A., që të gjithë nga fshati..., Komuna e Dragashit, me vendbanim në Prizren, Rr. “R. B.” nr..., të përfaqësuar, nga av. S. B. nga Dragashi, kundër të paditurve Komuna Dragash me seli në Dragash, të cilën e përfaqëson sipas prokurës Islam Rexheplar nga Dragashi dhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës – Drejtoria Koordinuese Rajonale në Prizren e përfaqësuar nga A. S. nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimi i pronësisë, **SI E TËRHEQUR**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e saja procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësit me dt. 27.10.2021 pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi, kundër të paditurve Komuna e Dragashit dhe Agjencionit të Pyjeve të Kosovës – Drejtoria Koordinuese rajonale në Prizren, me objekt të padisë vërtetimi i pronësisë.

Gjykata në lidhje me këtë çështje me dt. 22.11.2024 ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesorë ku kanë prezentuar palët nga padia dhe përfaqësuesit e tyre, ndërsa i autorizuari i paditësve av. S. B. nga Dragashi në deklaratën e tij ka theksuar: Pas konsultimit me palët që përfaqësoj dhe meqenëse këtu eksperti gjeometër në raportin e shkruar ka cekur se parcela – bazë e padisë në fakt sipërfaqja e kontestuar pranë Zyrës së Gjeodezisë dhe Kadastrit në Dragash e regjistruar Nr.007..-0 dhe Nr.007..-0 në vendin e quajtur “P. – Q.”, të regjistruar në emër të N. S. N., S. S. N. dhe K. S. N., në pjesë nga 1/3 e po ashtu siqë është theksuar në padi – kërkesëpadi, që

sipërfaqja e kontestuar – pjesa e parcelës 00001-1 ZK O. dhe pas bisedës telefonike këtu me paditësin M. A. që është edhe i autorizuar edhe i paditësve të tjerë, e Tërheqi padinë – Kërkesëpadinë e paditësve.

Përfaqësuesit e të paditurve Islam Rexheplar dhe A. S. nuk e kanë kundërshtuar deklarinimin e të autorizuarit të paditësve dhe nuk kanë kërkuar shpenzimet e procedurës.

Sipas dispozitave ligjor nga neni 261 par 1,2 të LPK, pala paditëse ka të drejtë ta tërheq padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri te paraqet përgjigjen në padi, ndërsa par.2, i të njëjti nen përcakton se padia mund të tërhiqet edhe me vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor në çoftë se i padituri e jep pëlqimin. Po qe se i padituri në afatin 7 ditësh, nga dita e njoftimi për tërheqje të padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimi për tërheqje të padisë. Gjykata duke e vlerësuar kërkesën e paditësit për tërheqje të padisë, dhe meqenëse kemi të bëjmë me kërkesa për të cilin palët mund të disponojnë lirshëm e nuk janë në kundërshtim me dispozita ligjor nga neni 3 par 3 të LPK/së, konsideron se janë plotësuar kushte ligjor komfor dispozitave ligjore nga neni 261 paragrafi 1, 2 të LPK/së, për tërheqje të padis, pasi që paditësi nuk ka interes juridik për këtë padi, për çka u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e lartcekura në kuptim të dispozitave ligjor nga neni 261 par 1. 2.4 të LPK/së, dhe nenin 387.1 pika c) te Ligjit te Procedurës Kontestimore, vendosi si në dispozitiv te këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:240958, 22.11.2024**

**G j y q t a r j a,**

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kunder këtij Aktvendimi nuk lejohet ankesa (neni 261.4 i LPK-së).